




Pranuar / Dorëzuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivety	28.12.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOM84/CK	6353/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.972/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetar, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.2078/19 të datës 15.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me datë 01.12.2021, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.134/2019 të datës 26.02.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rruga “12 Maji” Nr. 52 në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit me numër KA.nr.02/2019 të datës 20.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.134/2019 e datës 26.02.2019, e parashtruar nga ankuesi**
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër KA.nr.02/2019 i datës 20.02.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës së Apelit të Kosovës.**

A r s y e t i m

Me Vendimin me numër reference 877/18 të datës 05.12.2018, ankuesit në pozitën „Referent“ në Gjykatën e Apelit të Kosovës, i ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 28.12.2018, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Ankuesit me këtë vendimi i është njohur e drejta e pagesës së një page të njëhershme në vlerën e pagës së fundit e cila ankuesit i është kompensuar në muajin dhjetor 2018.

Ankuesi më datë 17.01.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës së Apelit të Kosovës, për pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit, duke u bazuar në nenin 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës së Apelit të Kosovës me datë 20.02.2019 ka nxjerr Vendim me numër KA.nr.02/2019 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me numër KA.nr.02/2019 të datës 20.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës së Apelit të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.02.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 998/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Gjykata e Apelit të Kosovës, ndërsa më datë 04.03.2019 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Gjykata e Apelit të Kosovës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 21.08.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 15.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2078/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 21.08.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 26.02.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 998/2019 të datës 26.02.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KA.nr.02/2019 të datës 20.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Njoftimin e datës 22.08.2018 për ankuesin; Vendimin me numër Reference 877/18 i datës 05.12.2018 i Kryetarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Ankesën e datës 17.01.2019 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën për pagesë retroaktive e datës 10.12.2018; Lista e pagave dhjetor 2018 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 04.03.2019 me numër protokoll 1138/2019; Njoftimin e datës 21.08.2019 dhe Aktgjykimin A.nr.2078/19 të datës 15.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dëguara nga ankuesi dhe organi i punësisimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës parasheh që punëtorëve ju takon pagesa në lartësi prej dy paga përcjellëse dhe tri pagave jubilarë.



Ankuesi me rastin e pensionimit përveç pagesës në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit të paguar nga Gjykata e Apelit të Kosovës, ka kërkuar edhe kompensimin e dy (2) pagave jubilarë dhe tri (3) pagave të tjera përcjellëse me rastin e pensionimit ashtu siç parashihet me Marrëveshje të Përgjithshme Kolektive.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pagat, shtesat në pagë dhe kompensimet e pagës për nëpunësit civilë, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe të akteve nënligjore përkatëse për zbatimin e këtij ligji, me të cilat përveç tjerash në mënyrë decedive përcaktohet edhe kompensimi i nëpunësve civilë me rastin e arritjes së moshës së pensionimit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që me dispozitat e nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë është përcaktuar që nëpunësit civilë, përveç tjerash kanë të drejtat në vijim:... **„2.2. pagesën për shkak të pensionimit”**

Po ashtu me dispozitat e nenit 19 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, është përcaktuar që: **„Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit”.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të ofruara nga organi i punësimit, gjegjësisht listës së pagave të muajit dhjetor, konstaton që ankuesit i është bërë kompensimi në shumën bruto prej 588.95 Euro si pagesë në shumën e një page mujore në vlerën e pagës së fundit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marr parasysh faktet e lartcekura konstatoi që ankuesit i është bërë kompensimi me rastin e pensionimit, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, dhe për këtë arsye vendosi të refuzoj ankesën si të pabazuar, pasi që kërkesa për pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit është e bazuar në Kontratën Kolektive, e cila ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ku përcaktohet që: **“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”,** mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: **“Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës”,** bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: **“Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”,** mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes, prandaj mbi bazë të kësaj mund të konstatojmë që kjo marrëveshje ka qenë në fuqi deri më datë 15.09.2017 dhe si rrjedhojë kjo marrëveshje nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike dhe se e njëjta nuk është nënshkruar më nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, në rastin konkret pasi që ka analizuar dëshmitë e ofruara gjegjësisht Vendimin me numër reference 877/18 të datës 05.12.2018, me të cilin ankuesit i është përfunduar marrëdhënia e punës me rastin e pensionimit, ka konstatuar se rrjedhimisht ankuesit nuk mund të bëhet kompensimi i tri pagave me rastin e pensionimit sipas Marrëveshjes Kolektive të Kosovës, dhe mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i pabazuar.



Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, meqenëse konstaton që Marrëveshja Kolektive e Kosovës nuk është në fuqi, atëherë kompensimi me rastin e pensionimit të nëpunësve civil duhet të bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë. Andaj ne rastin konkret Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave duke u bazuar ne dëshmitë e ofruara, konstaton se Gjykata e Apelit Kosovës ankuesit i ka bërë kompensimin e një page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit në muajin dhjetor 2018, dhe se me rastin e kompensimit të ankuesit ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Gjykatës së Apelit të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.nr.02/2019 të datës 20.02.2019 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.972/2021

Avdyll BEKTESHI
për Çështjet
Procesmbajtës

Malsore Gashi-BAJRAKTARI
Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës;
- Administratorit të Gjykatës së Apelit të Kosovës;
- Znj. *Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; dhe*
- Arkivit të KPMSHCK-së.